

Anëtarësim I Asociuar

ERiac është një organizatë e bazuar në anëtarësim, që sjell së bashku individë dhe organizata Rome dhe jo-Rome, me kompetenca të demonstruara e relevante dhe eksperiencë në fushën e artit e të kulturës të cilët janë të përkushtuar ndaj vlerave të ERiac-ut.

Anëtarët e asociuar të ERiac janë organizuar në pesë sesione tematike:

- Arte dhe Kulturë
- Histori dhe Përkujtim
- Kërkime dhe Publikime në fushat e artit dhe kulturës
- Media dhe Informacioni në fushat e artit dhe kulturës
- Gjuha Rome

Cilat janë përfitimet i të qënurit anëtar i asociuar i ERiac?

Anëtarët e asociuar kanë rol kyç në ndërtimin e burimeve të ERiac, duke u angazhuar në shkëmbime krijuese dhe bashkë-prodhim, duke marrë në pronësi iniciativat dhe angazhim në vendimmarrje të ERiac.

Si një anëtar i asociuar:

- Do të kesh akses të plotë në informacionin dhe njohuritë në burimet, koleksionet, arkivat dhe bazat e të dhënave të ERiac.
- Do të jesh i përfshirë sa më shumë të jetë e mundur në programin e aktiviteteve të ERiac.
- Do të jesh i ftuar për të sygjëruar iniciativa kulturore, artistike dhe partneritete.
- Nëpërmjet seksioneve tematike, do të keni mundësi për ti dhënë formë prioritetëve dhe aktiviteteve të ERiac.
- Do të jesh pjesë e platformës për shkëmbim idesh dhe ekspertize të ERiac.
- Bazuar në kushtet e vendosura nga ERiac, do të kesh mundësi për të vendosur logon dhe emrin e institutit në aktivitetet e tua.
- Do të kesh të drejtën për të marrë pjesë në Asembletë e Përgjithshme.
- Do të mund të nominoni anëtarë të *Barvalipe Academy* ose të kandidoni për anëtar të Barvalipe Academy.

Kush mund të bëhet pjesë?

ERAC është e hapur për të gjithë artistët Romë dhe jo-Romë, menaxherë kulturorë, individë të interesuar, organizata të shoqërisë civile, kompani private, grupe formale dhe jo formale me kompetenca të demonstruara dhe eksperiencë në fushën e arteve dhe kulturës që mbështet qëllimin e ERAC dhe që janë të gatshëm për të kontribuar në implementimin e fuqizimit të vizionit të ERAC.

Aplikimet pranohen nga persona juridikë dhe fizikë.

Cilat janë kërkesat për të qënë një anëtar i asociuar?

- Aplikimet e anëtarëve shikohen nga Menaxheri Ekzekutiv dhe Bordi IPakiv, bazuar në demonstrimin e meritave dhe kualifikimeve në fushë gjerësisht-kuptuar arte dhe kulturë.
- Anëtarët e asociuar duhet të zotohen për të respektuar **principet e fondit të ERAC**.
- Anëtarët e asociuar priten **të paguajnë tarifën e zakonshme të anëtarësimit**.
- Anëtarët e asociuar bazuar në preferencat dhe eksperiencat e veta, ukërkohet të zgjedhin në seksionin e tematikave. Anëtarët e asociuarmund të zgjedhin më shumë se një seksion.

Si mund të bëhem një anëtar i asociuar?

Thirrja e 2023 për anëtarët e asociuar do të hapet më 13 shkurt – dhe do të qëndrojë e hapur deri më 17 prill 2023. Anëtarësimi i asociuar mund të merret duke plotësuar një formular aplikimi online.

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen nga Menaxhmenti Ekzekutiv i ERAC dhe Bordi i Pakiv. Pasi aplikimi të miratohet, aplikanti do të duhet të sigurojë një dëshmi të pagesës për t'u bërë anëtar i plotë.